



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI

Nr. 40 prot.

Tiranë, më 14.01.2020

**URDHËR**

Nr. 2, Datë 14/01/2020

**MBI**

**“PAGESËN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË  
TË STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020 NË UNIVERSITETIN E  
ARTEVE”**

Bazuar në nenin 3 shkronja ç, nenin 39, nenin 98, pika 2, shkronja c, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pikën 3, të nenit 113 të ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave...” dhe Vendimit të Bordit të Administrimit nr.15, datë 13.06.2019 “Mbi miratimin e tarifave të ciklit të dytë të studimeve për studentët mbetës dhe përsëritës në fakultetet e Universitetit të Arteve”:

**URDHËROJ**

1. Pagesën e tarifës së shkollimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2019-2020, në Universitetin e Arteve.
2. Studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor, në Fakultetet e UART, të kryejnë pagesën vjetore të tarifës së shkollimit deri në datë 31.01.2020.
3. Sekretaritetë e Fakulteteve sipas rregullores të fakulteteve të dorëzojnë në Drejtorinë Ekonomike:
  - a) Listen emërore të studentëve me mesatare mbi 6 për ciklin e parë të studimeve,
  - b) Listën emërore të studentëve përsëritës,
  - c) Listen emërore të studentëve me detyrime të pashlyera.
4. Studentët e ciklit të dytë të studimeve master, në Fakultetet e UART, të kryejnë pagesën vjetore të tarifës së shkollimit të ndarë në dy këste, kësti i parë të paguhet në

